



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1075/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni duke vendosur përkritazi me apelin e Pëllumb Kurhasku, anëtarë për Kuvendin Komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën (NISMA) me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 16.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Pëllumb Kurhasku, anëtarë për Kuvendin Komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën (NISMA) me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, me shenjën ZL.Anr.1075/2017, të datës 16.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 16.11.2017 ka pranuar apelin ZL.Anr.1080/2017 të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 10.11.2017, nga Pëllumb Kurhasku, anëtarë për Kuvendin Komunal në Gjakovë, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, i njëjti i protokolluar me datën 16.11.2017 me të cilin apel ka pretenduar se në Qendrat e Votimit QV. nr. 0205C, 0213C, 0202C, 0203X, 0203C ka pasur pa rregullsi, duke theksuar se në Qendrat e Votimit më kanë votuar familjarët e tij dhe votat e tij nuk janë të evidentuara pasi që të njëjtat i mungojnë.

PZAP-i, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve në apel si dhe shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel gjeti se parashtruesi në apel me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij në apel. Prandaj, Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.1075/2017 më datën 16.11.2017.



Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*